



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201602459/4

Tiranë ___/___/2016

Lënda: Rekomandohet "Marrja e masave me qëllim hetimin e shpejtë të procedimeve penale, vënien në dispozicion të akteve të fashikullit të hetimit palëve në procesin penal, dhe njohjen e tyre me mënyrën e zgjidhjes së kallëzimeve penale apo përfundimit të hetimit të çështjes penale.

Drejtuar: Sekretarit të Përgjithshëm
Z.Gent KOSUMI

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

TIRANË

I nderuar Z. Sekretar i Përgjithshëm,

Në veprimtarinë e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016, gjatë trajtimit të ankesave qytetare të ndryshëm kanë paraqitur shqetësime apo ngritur pretendime ndaj organit të Prokurorisë në 102 raste. Në mënyrë të grupuar kërkesë/ankesat paraqiten si më poshtë:

1. Për zvarritje të pajustificuara në hetimin e procedimeve penale.

Raste të tilla janë 14 dhe mund të përmëndim disa prej tyre me zvarritje të theksuara:

Ankesa me numer 201602001 e shtetasës M. Ll., ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për zvarritje në hetimin e procedimit penal nr.2695, rregjistruar më datë 26.03.2016, për veprën penale "Vjedhja me dhunë", në ngarkim të bashkëshortit të saj L. Ll. Hetimet janë përfunduar më datë 26.09.2016.

Ankesa me numer 201600935, e shtetasit E. I., nga Tirana, ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për zvarritje në hetimin e procedimit penal nr.175, muaji Mars 2015, ndaj shtetasit E. I., për veprën penale "Vjedhja me armë", parashikuar nga neni 140 e 25 të Kodit Penal. Hetimet e këtij procedimi penal kanë përfunduar më datë 10.10.2016, dhe çështja penale është dërguar në gjyq.

Ankesa me numer 201600987, e shtetasit S. T., nga Elbasani, ndaj Prokurorisë së atij rrethi, për zvarritje në hetimin e procedimit penal nr.1289, datë 23.06.2015, për veprën penale “*Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë*”, me pasojë vdekjen e djalit të tij Q. T. Procedimi penal ndodhet në fazën e hetimit dhe nuk është përfunduar.

Ankesa me numer 201601668, e shtetasës H. Ç., nga Gramshi, ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për zvarritje në hetimin e procedimit penal nr.1039 të vitit 2014, për veprën penale “*Mjekimi i pakujdesshëm*”, hetimet e të cilit janë përfunduar më datë 26.07.2016, dhe çështja është dërguar në gjyq me të pandehur mjekun H. K.

Ankesa me numer 201601540, e shtetasit I. T., nga Kurbini, drejtuar Prokurorisë së atij rrethi, për zvarritje në hetimin e procedimit penal nr.365 datë 24.09.2015, për veprën penale “*Vrasja në rrethana të tjera cilësuese*” etj, e cila bën fjalë për vrasjen e djalit të tij, të ndjerit N. T. Hetimet e këtij procedimi penal janë përfunduar më datë 30.05.2016, dhe çështja është dërguar në gjyq.

Ankesa me numer 201601799, e shtetasit M. D., nga Vlora, ndaj Prokurorisë së atij rrethi për zvarritje të hetimit të procedimit penal nr.514 datë 23.03.2016, për veprën penale “*Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike*”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal, hetimet e të cilit janë përfunduar brenda afatit të fundit, datë 23.09.2016.

Ankesa me numer 201601956, e shtetasit Xh. O., nga Kukësi, i cili ankohet ndaj Prokurorisë së atij rrethi, për zvarritje në hetimin e procedimit penal nr.283, datë 20.10.2015, për veprën penale “*Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike*” parashikuar nga neni 175 i Kodit Penal. Hetimet e procedimit penal janë përfunduar më datë 28.07. 2016.

Ankesa me numer doculive 201602057, e shtetasës L. A., nga Saranda, ndaj Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë, për zvarritje në hetimin e procedimit penal nr.40 datë 25.05.2011, për veprën penale “*Trafikimi i narkotikëve*” në ngarkim të djalit të saj A. A., etj.

Më datë 26.06.2015, është vendosur pushimi i hetimeve, në pritje të akteve në ekzekutim të leterporosive, Pas ardhjes së tyre nga autoritetet gjyqësore greke Prokuroria e Përgjithshme më datë 18.07.2016, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit të çështjes penale. Pas zgjatjes së hetimeve ato janë përfunduar më datë 30.12.2016, dhe çështja penale është dërguar në gjyq.

Konstatime

Për rastet e zgjatjes të hetimit, të përmendura më sipër, organi i Prokurorisë ka justifikuar me procedurat e ndërlikuara që kanë kompanitë celulare për vënien në dispozicion të të dhënave të kërkuara; kryerjen e ekzaminimit psikiatriko-ligjor të personit të dyshuar në kryerjen e veprës penale ose kthimi me vonesë i përgjigjes së aktit të ekspertimit; në vonesa të aktit të ekspertimit bio- kimik të lëndëve të dyshuara si narkotike; në mosgjetjen e personave të dyshuar si autor i kryerjes së veprës penale në vëndbanimet e tyre etj.

Përfundime

Mendojmë se, arsyet e zvarrijtes së hetimit të procedimeve penale janë edhe subjektive, qëndrime të cilat konsistojnë në:

- a. Moskryerjen e veprimeve hetimore në vazhdimësi.
- b. Mosndjekjen e detyrave të lëna nga prokurori i çëshjes në urdhërin e delegimit drejtuar oficerit të Policisë Gjyqësore.
- c. Mosndjekjen e problematikave nga drejtuesi i Prokurorisë për rastet e dërgimit të shkresave drejtuar Institutit të Mjekësisë Ligjore, Institutit të Policisë Shkencore dhe, Prokurorisë së Përgjithshme për letërporositë drejtuar autoriteteve të drejtësisë të shteteve të huaja.
- ç. Mosndjekja në vazhdimësi e materialeve kallëzuese të qytetarëve, apo materialeve procedurale hetimore të dërguara nga Komisaritet e Policisë, sidomos me persona pa masë shtrënguese dhe kjo më e theksuar para ditëve të festive zyrtare, pushimit apo në fundviti.

2. Në mosdhënien e kopjeve të akteve të fshikullit të hetimit, ose moskthim përgjigje memorieve dhe kërkesave me shkrim, palëve në procesin penal.

Raste të tilla janë 9 dhe nga këto mund të përmëndim:

Ankesa me numer 201601575, e shtetasit F. M., nga Laçi, i cili ankohet ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin, për mosdhënie të kopjeve të aktit të ekspertimit mjeko-ligjor të administruar në dosjen hetimore në ngarkim të pandehurit N. G. Në përgjigjen që Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin, i ka kthyer Institucionit të Avokatit të Populloit, informon ndërmjet të tjerave se, *çështja penale ishte dërguar në gjyq dhe se ankuesi për të marrë kopje të aktit të ekspertimit mund t'i drejtohej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin*. Shprehim mendimin se organi i Prokurorisë duke patur të administruar në fashikullin e hetimit aktin e ekspertimit mjeko ligjor, duhet t'i vinte në dispozicion qytetarit kopje të atij dokumenti.

Ankesa me numer 201901909, e shtetasit kosovar Y. D., ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi nuk i ka dhënë letërnjoftimin personal të lëshuar nga Republika e Kosovës, dokument i sekuestruar gjatë hetimit të procedimit penal për veprën penale *“Mjekim i pakujdesshëm”* në ngarkim të tij, edhe pse gjykata e ka deklaruar të pafajshëm.

Ankesa me numer 201602459, e shtetasit A. B., nga Lezha, i cili ankohet ndaj Prokurorisë së atij rrethit për mosvënie në dispozicion të kopjeve të aktit të ekspertimit tekniko-grafik të nënëshkrimit.

Konstatime

a. Nuk respektohen kërkesat e parashikuara në pikën 2 të nenit 105 të Kodit të Procedurës Penale, për shqyrtimin e kërkesës së palëve për marrje të kopjeve të akteve, etj. Në disa raste në përgjigjen drejtuar qytetarit mosdhënia e akteve është arsyetuar me faktin se *“aktet përbëjnë sekret hetimi”*.

b. Nuk respektohen kërkesat e parashikuara në nenin 110 të Kodit të Procedurës Penale, kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë paraqitur memorie ose kërkesa me shkrim, lidhur me pretendime të ndryshme si për akuzën, pyetjen e dëshmitarëve, kryerjen e ekspertimeve etj. Për rrjedhojë, nga organi procedues nuk zbatohet pika 2 e nenit 110 të K.Pr.Penale, për t'u shprehur me vendim të arsyetuar brënda pesëmbëdhjetë ditëve.

Përfundime

a. Veprimet e organit të Prokurorisë vijnë ndesh me dispozitat e përcaktuara në nenin 3 të ligjit nr.119/2014 “Për të dretjën e informimit” dhe dispozitat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

b. Mosdhënia e akteve apo mosshqyrtim i kërkesave të palëve në procesin penal, është me pasoja në zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor

3. Në mosnjoftimin ose njoftimin me vonesë për rastet e mënyrës së zgjidhjes së kallëzimeve penale, apo përfundimit të hetimit të çështjes penale,

Gjatë vitit 2017, raste të tilla janë 10 dhe mund të përmëndim:

Ankesa me numer doculive 201600525, e shtetasës K. Ç., nga Fieri, ndaj Prokurorisë së atij rrethi për mosvënie dijeni, lidhur me mënyrën e zgjidhjes së kallëzimit penal të vitit 2015 në ngarkim të shtetasit Th. Ç., për veprën penale “*Marrëdhënie seksuale me të mitur më shumë se një herë*”, parashikuar nga neni 100/2 dhe 50 gërma “g” e Kodit Penal. Gjatë trajtimit të kësaj anekese dhe përgjigjes së kthyer nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, jemi informuar për faktin se kallëzuesja K. Ç., është njoftuar nga Prokuroria me shkresën nr..2310/1 datë 08.03.2016, për faktin se procedimi penal nr.1280/2015, në ngarkim të xhaxhait të saj Th. Ç., është dërguar për gjykim, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Ankesa me numer doculive 201600416, e shtetasit P. K., nga Puka, ndaj Prokurorisë së atij rrethi, për faktin se nuk e ka njoftuar lidhur me mënyrën e zgjidhjes së kallëzimit penal të muajit Maj 2015, për ushtrim dhune ndaj shtetasve V. dhe A. K.

Gjatë trajtimit të ankesës në përgjigjen e Prokurorisë Pukë, jemi informuar për faktin se për dëmtimet e shkaktuara shtetasit P. K., organi i Prokurorisë ka kryer riekspertim mjeko- ligjor dhe në përfundim, ka dërguar çështjen penale në gjyq për veprën penale “*Plagosje e lehtë me dashje*”, për të cilën ka njoftuar të dëmtuarin.

Konstatime

a. Ka vonesa në dërgimin e shkresave për njoftimin e kallëzuesit të veprës penale, lidhur me mënyrën e zgjidhjes së kallëzimit, apo vendimit përfundimtar të hetimit.

b. Për rastet e dërgimit të materialeve hetimore proceduriale nga Policia Gjyqësore e Policisë së Shtetit, për vepra penale që përfshihen në nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale, Prokuroria vendos mosfillimin e procedimit penal, pa sqaruar të dëmtuarin nga vepra penale, për rrugën që duhet të ndjekë, kërkesën drejtuar gjykatës.

Përfundime:

Më tepër transparencë në komunikimin me kallëzuesin dhe palët në procesin penal, për mënyrën e zgjidhjes së kallëzimeve penale dhe më tej ecurinë e hetimeve apo mënyrën e përfundimit të tyre.

4. Në kthimin me vonesë të përgjigjeve të rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe mosnjoftimin për vendimin përfundimtar të marrë pas fillimit të hetimeve të procedimit penal.

Siç jeni në dijëni Avokati i Popullit gjatë vitit 2016, ka paraqitur pranë organit të Prokurorisë 9 rekomandime kryesisht për fillimin e hetimeve të procedimeve penale për vepra penale si “Kryerja e veprimeve arbitrare”, “Shpërdorim detyre”, apo dhe “Torturë”.

Në të gjitha rastet rekomandimet i janë drejtuar drejtuesit të Prokurorive të Rretheve Gjyqësore përkatëse, duke vënë në dijëni Prokurorin e Përgjithshëm.

Konstatime

Vlerësojmë qëndrimin e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm e cila në të gjitha rastet ka marrë në shqyrtim rekomandimin dhe mandej me shkresë ka njoftuar jo vetëm Institucionin e Avokatit të Popullit, por dhe Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, për të vlerësuar dhe ndjekur rekomandimin.

Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore kthejnë me vonesë përgjigjen si për faktin e marrjes në shqyrtim të rekomandimit të Avokatit të Popullit, ashtu edhe për mënyrën e përfundimit të hetimit të procedimit penal.

Le për të dëshiruar qëndrimi i organi të Prokurorisë në marrjen e vendimeve përfundimtare mbi mënyrën e zgjidhjes së rekomandimeve të Avokatit të Popullit, ku pas fillimit të hetimit në disa raste ka pushuar çështjen penale.

Përfundime

Shprehim mendimin se gjatë vitit 2017, bashkëpunimi me organin e Prokurorisë duhet të realizohet qysh në fazën e bërjes së rekomandimit, duke paraqitur dhe përfundimet konkrete që kanë dalë nga kryerja e hetimit të pavarur administrativ. Kjo, për rastet kur kërkohet fillimi i hetimit të procedimit penal, ose marrja e masave disiplinore ndaj punonjësve të Prokurorisë.

Duke paraqitur një tablo të trajtimit të ankesave të qytetarëve ndaj organit të Prokurorisë, kemi mbajtur parasysh misionin e Avokatit të Popullit, si një institucion i pavarur kushtetues në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të shtetasve edhe në procesin penal. Kjo për faktin se organi procedues ndaj qytetarëve ka ngritur një akuzë në procesin penal, ose ata janë të dëmtuar nga vepra penale, por që ju cënohen të drejtat e tyre, me veprimet ose mosveprimet e punonjësit të Prokurorisë.

Të drejtat e personave ndaj të cilëve është ngritur një akuzë parashikohen në nenet 28, 42/2 dhe 131 shkronja “f” e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenet 323, 324, 105 dhe 110 e Kodit të Procedurës Penale si dhe nenin 6 të KEDNJ.

E drejta për një proces të rregullt ligjor është një e drejtë kushteuese, e cila e vendos organin procedues para një sërë detyrimesh, duke filluar nga vënia në dijëni e individit për shkakun e akuzës së ngritur ndaj tij, respektimin e të drejtave procedurale dhe zhvillimin e hetimit dhe gjykimit brënda një “afati të arsyeshëm”, pa lejuar zvarritje të papërligjura dhe arbitrare të organit procedues. Shpejtimi i procedurave të hetimit dhe gjykimit është i lidhur drejtpërsëdrejti me të drejtat dhe liritë themelore nga njëra anë, dhe detyrimin për realizimin e një hetimi e gjykimi objektiv, të plotë, të saktë e të shpejtë nga ana tjetër.

Gjatë trajtimit të kërkesë/ankesave të qytetarëve për vitin 2016, kemi konstatuar një bashkëpunim të mirë institucional, e cila ka konsistuar në kthimin e shpejtë të përgjigje të shkresave tona “Kërkesë për informacion” ose dërgimin e kopjeve të akteve të

ndryshme nga fashikulli hetimit. Ka patur mirëkuptim dhe për raste të marrjes së informacionit nga drejtues të Prokurorive gjatë komunikimit me Ndhmëskomisionerin që trajton ankesat, apo në raste të veçanta dhe me prokurorin e çështjes.

Në përfundim do të sugjeronimin që rastet e mësipërme të bëhen objekt i analizës së punës së Prokurorisë duke vënë theksin në hetimet e shpejta, dhënien e kopjeve të akteve palëve në procesin penal, njoftimin sa më parë për mënyrën e zgjidhjes së kallëzimeve, vendimit përfundimtar të hetimit dhe rritjes së aftësive profesionale e morale të prokurorëve, si dhe sjelljes etike të tyre me palët në procesin penal, apo familjarë të tyre.

Për sa më sipër , bazuar në pikën 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut nga administrata publike”, si dhe nenin 21 gërma “b” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, me ndryshimet përkatëse, ku thuhet : “Avokati i Popullit.....paraqet rekomandime për vënien në vënd të së drejtës të shkelur tek organi administrativ që sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave të njeriut”.

REKOMANDOJMË

“Marrja e masave me qëllim hetimin e shpejtë të procedimeve penale, vënien në dispozicion të akteve të fashikullit të hetimit palëve në procesin penal, dhe njohjen e tyre me mënyrën e zgjidhjes së kallëzimeve penale apo përfundimit të hetimit të çështjes penale.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij Rekomandimi, lutemi navini në dijeni brënda afati ligjor prej 30 ditësh, të parashikuar në nenin 22 i ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj.

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI